

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1031 Prot.

Tiranë, më 02.08 2017

VENDIM Nr. 155, datë 26.07.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, datë 26.07.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Gërmimit Arkeologjik të Shpëtimit në zonën e përcaktuar si zonë me potencial arkeologjik Chance Find, Berat - Lapardha *KM 156 +380*, "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*" - subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Gërmimit Arkeologjik të Shpëtimit në zonën e përcaktuar si zonë me potencial arkeologjik Chance Find, Berat - Lapardha *KM 156 +380*, "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*" -subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të vijojnë punimet e ndërtimit të tubacionit të Linjës së gazjellësit TAP, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 99, datë 14.09.2016, për Fushatën e II (KM 0-69).
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO